

**VENDIM**  
**Nr. 749, datë 9.12.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E  
RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DHE  
CAKTIMIN E INSTITUTIT TË NDËRTIMIT  
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit, me vlerë të plotë, në masën 68 930 414 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë, pa TVSH.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim” 01110, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” shtohet fondi prej 13 786 083 (trembëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e tre) lekësh pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit.

3. Instituti i Ndërtimit caktohet si njësi zbatuese për zbatimin e projektit të rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Instituti i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**